KEDS
KËSHILLA PËR SIGURI
NGA ENERGJIA ELEKTRIKE
brenda dhe jashtë shtëpisë tuaj

Të dashur fëmijë,

Ju tashmë jeni rritur dhe çdoherë e më shumë jeni kureshtarë të provoni lojëra të ndryshme për t'u argëtuar. Bota që na rrethon është e mbushur me plot mundësi të bukura, por mos harroni se ka edhe befasi të papritura, që mund të paraqesin rrezik për sigurinë tuaj nëse nuk jeni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm.
Kjo fletushkë ju ofron këshilla se si të jeni të sigurt nga energjia elektrike kudo, qoftë në shtëpi apo jashtë saj. Këshillat do ju përcjellin ngado, ngase energjia elektrike gjendet gjithandej, edhe aty ku ju nuk e shihni.

Shpresojmë që pas leximit të saj, JU të bëheni KAMPIONË të njohurive për siguri nga rryma dhe ato t'i përcillni ngado që të shkoni dhe këdo që do ta takoni.

Lexim të këndshëm!

Si të veproni brenda shtëpisë suaj

Fëmijë të dashur,

Energjia elektrike jo vetëm që ndriçon shtëpitë tuaja, por edhe ju mundëson që të shikoni televizor, të dëgjoni muzikë apo edhe të luani video-lojërat e preferuara. Derisa energjia elektrike na lehtëson aktivitetet e përditshme brenda shtëpisë, duhet të jemi të vetëdijshëm edhe për rreziqet që mund të shkaktojë nëse nuk jemi të kujdesshëm kur e përdorim atë. Këshillat e mëposhtme janë shumë të rëndësishme për ju, andaj ju ftojmë t'i lexoni me VËMENDJE.

Asnjëherë mos i fusni gishtat
ose objektet e tjera në prizë!

Asnjëherë mos e tërhiqni me forcë kabllon elektrike nga priza! Nëse shikoni se një kabllo elektrike është e dëmtuar, informo menjëherë prindin dhe në asnjë mënyrë mos tento ta prekësh!

Asnjëherë mos përdorni pajisje elektrike me duar dhe këmbë të lagura!

Kini kujdes gjatë vënies në funksion të pajisjeve elektrike në kuzhinë. Mund të shkaktoni zjarr me pasoja të mëdha për ju dhe gjithë familjen!

Asnjëherë mos provo të përdorësh tharësen për flokë në banjon e lagur!

Dhe asnjëherë MOS HARRONI - Uji dhe energjia elektrike janë armiq të njëri- tjetrit, andaj MOS provoni të përdorni pajisjet elektrike ku ka ujë!

Nëse e shihni ndonjë pajisje elektrike të përfshirë nga zjarri, mos hidhni ujë mbi të! Lajmëroni një të rritur dhe largohuni nga aty menjëherë!

Nëse shihni kabllo vazhdues të rrymës që kalon mbi tepih, atëherë tregoni prindërve tuaj, sepse kabllot mund të tejnxehen dhe rrezikojnë të shkaktojnë zjarr.

Si të veproni jashtë shtëpisë suaj

Fëmijë të dashur,

Ne e kuptojmë plotësisht kureshtjen dhe dëshirën tuaj për të provuar gjëra të reja, por jo të gjitha janë pa rreziqe. Sapo të dilni nga shtëpia, ju mund të hasni në objekte të ndryshme energjetike, qofshin ato: trafostacione, shtylla, përçues e linja elektrike. Ato ndriçojnë shtëpitë tuaja, por duhet të jeni të kujdesshëm që të mos t'u afroheni apo të tentoni t'i prekni ato.

Ju duhet të jeni të sigurt edhe kur jeni jashtë shtëpisë, prandaj, më poshtë kemi listuar udhëzimet dhe këshillat se si të mbroheni dhe t'i njihni rreziqet që mund të paraqiten nga energjia elektrike.

Nëse ju bie topi apo diçka tjetër brenda rrethojave të trafostacioneve, mos provoni t'i merrni vetë ato, madje edhe nëse ju duket fare e lehtë! Mos provoni t'i tërhiqni me ndonjë mjet, qoftë edhe me një shkop! Njoftoni prindërit tuaj dhe ata do të na kontaktojnë.

Nëse jeni duke luajtur jashtë me të tjerët, asnjëherë mos u afroni afër objekteve / pajisjeve elektrike! Ato janë burime të energjisë dhe si të tilla janë të rrezikshme për ju!

Ngjitja në shtyllë elektrike është rreptësisht e ndaluar. Përpos që mund të rrëzoheni nga shtylla, ju mund të merrni lëndime fatale nga kontakti me energjinë elektrike.

Në rast se jeni duke luajtur jashtë e ju zë stuhia, mbani mend, ju duhet që t'i shmangeni drunjëve dhe objekteve të larta, sepse mund të rrezikoheni nga rrufeja.

Fluturaket mund të jenë mjaft argëtuese për ju, por ato nuk duhet t'i përdorni në vendet ku ka linja të energjisë elektrike.

Asnjëherë mos i prekni ose të ngjiteni në pemët që janë afër linjave elektrike dhe asesi mos kaloni rrethojat e objekteve ku ka energji!

Në rast se shihni ndonjë shtyllë të dëmtuar apo ndonjë kabllo elektrike të këputur, në asnjë mënyrë mos tentoni t'iu afroheni! Ato edhe pse janë të rrëzuara apo të këputura, ende mund të jenë të energjizuara dhe si të tilla mund të jenë fatale për ju nëse i prekni.

Derisa jeni duke u argëtuar, në rast se ndokush nga shoqet/ shokët bie në kontakt me energjinë elektrike, mos u afroni afër tyre dhe asnjëherë mos provoni t'i prekni ata, sepse edhe ju mund të bëheni pjesë e rrezikut!

Kaq kishim për ju!

Tani, informatat dhe këshillat që keni marrë nga kjo broshurë ndani me shoqet dhe shokët tuaj. Kështu, ju do të ndihmoni të tjerët që derisa luajnë dhe argëtohen brenda apo jashtë shtëpisë, të qëndrojnë të sigurt nga energjia elektrike.

keds-energy.com